



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:240277

Datë: 20.05.2024

Numri i dokumentit: 05708441

KPPP.nr. 1785/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit “Interplast Group” Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, fshati Shupkocvë, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arbnor Murturi nga shoqëria e avokatëve “RZZ Law” me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 278/23, i lejuar me datë 17.10.2023, nga Përbaruesi Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Mitrovicës me seli në Mitrovicë, ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 278/23, i lejuar me datë 17.10.2023, nga Përbaruesi Privat Eset Murati, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Interplast Group”, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 4642/20, e datës 19.10.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, në emër të borxhit sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 2,199.90 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e rënies në vonesë me datë 20.10.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përbarimit, me arsyetim se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor nuk përmban vulën dhe numrin e protokollimit të debitorit, por vetëm një nënshkrim i cili nuk mund të verifikohet se nga kush është nënshkruar, prandaj nuk

mund të konsiderohet si dokument i besueshëm. Ka shtuar se meqenëse fatura në bazë të së cilës është iniciuar procedura përbarimore nuk ka tipare të përbarueshmërisë dhe urdhri përbarimor nuk i plotëson elemente e kërkuara me Ligjin për Procedurën Përbarimore. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përbarimor të anulohet, si dhe të obligohet kreditori që të paguajë shpenzimet e procedurës përbarimore në emër të prapësimin të ushtruar në vlerë prej 104.00 €.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se urdhri përbarimor është lejuar në bazë të faturës e cila është në origjinal, është pranuar nga debitori me datë 19.10.2020 dhe nuk është denoncuar nga i njëjti, ku edhe në shkresat e lëndës gjendet fletë dërgesa mbi pranimin e mallit nr. 4642/20, e datës 19.10.2020. Ka shtuar se debitori pretendimet e tij nuk i ka mbështetur me prova, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përbarimor duhet të anulohet për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti urdhri përbarimor P.nr. 278/23, i datës 17.10.2023 është mbështetur në faturën nr. 4642/20, e datës 19.10.2020, e cila nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se fatura e lartcekur nuk është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, qoftë përmes vulës së pranimit të shkresave të debitorit si institucion publik apo pranimit të faturës nga personi përgjegjës i debitorit. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se subjekti Komuna e Mitrovicës i evidentuar si debitor në propozimin për përbarim, nuk e ka

cilësinë e debitorit në dokumentin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi, element ky që kërkohet sipas nenit 29.3 të LPP-së.

Si rezultat i kësaj, Gjykata erdhi në përfundim se Fatura nr. 4642/20, e datës 19.10.2020, mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi nuk është e përshtatshme për përmbarim dhe nuk paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga të lartcekurat, e në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1785/23, datë 20.05.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.